



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES PËR PROJEKT
RREGULLORE PËR TRANSFERIMIN E
NËPUNËSVE NË ADMINISTRATËN E
SISTEMIT GJYQËSOR

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo projekt rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për transferimin e përkohshëm, të përhershëm dhe transferimin në rast të ristrukturimit në administratën e sistemit gjyqësor.

Kjo projekt rregullore synon që dispozitat e saj të aplikohen për të gjithë të punësuarit në administratën gjyqësore, duke përfshirë njësit e Këshillit, PZAP dhe Gjykatat. Përjashtimisht nga kjo, dispozitat nuk do të zbatohen për të punësuarit për të cilët Këshilli ka paraparë rregullim të veçantë të transferimit.

Projekt rregullorja përcakton disa lloje të transferimit të përkohshëm, duke filluar nga transferimi në interes të institucionit, për përmirësimin e rezultateve në punë, për arsye të përkohshme shëndetësore si dhe transferimin e përkohshëm në një organizatë ndërkombëtare.

Projekt rregullorja gjithashtu e parasheh edhe transferimin e përhershëm, transferimin në rast të shuarjes apo ristrukturimit, procedurat

	<p>qe duhet ndjekur në rast të ristrukturimit, themelimin e Komisionit të ristrukturimit, vendimin lidhur me transferin dhe lista e pritjes e deri tek e drejta e ankesës.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Hartimi i projekt rregullore për transferimin e nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor, është paraparë e nevojshme për shkak të ndryshimeve ligjore, përkatësisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik sipas së cilit kërkohet një rregullim i veçantë për procedurën e transferimit të nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor.</p> <p>Projekt rregullorja përcakton në mënyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse kriteret dhe standardet e njëjta për të gjithë nëpunësit në rast të transferimit në administratën e sistemit gjyqësor. Me anë të së cilës synohet që të arrihet efikasiteti, transparenca zhvillimi i mëtejme në karrierë, si dhe krijimi i një mjedisi sa më të përshtatshëm të punës.</p> <p>Rregullorja gjithashtu ka numëruar taksativisht rastet e transferimit të përhershëm të nëpunësit dhe transferimet e tjera. Vendimi për transferimin e një nëpunësi merret me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe kryhet pas kërkesës së vet të nëpunësit, ose në rastet kur transferimi shqiptohet nga Komisioni Disiplinor i Këshillit.</p> <p>Duke theksuar se hartimi i kësaj projekt rregullore për transferimin e nëpunësve konsiderohet si një akt unifikues për sistemin e administratës gjyqësore, duke u bazuar në një rregullore të vetme. Kjo procedurë nuk ka qenë e rregulluar më parë me një akt veçantë</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të</p>

	<p>projekt Rregullore për transferimin e nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 20 prill 2024.</p>
4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>